REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 272,281/20
Datë/Datum. 22.05.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Visar Basha	12.05.2020	22.05.2020

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 29.04.2020, OE "Joos Krasniqi", ka parashtruar ankesë me nr: 272/19, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, me titull: "Ndertimi i rruges Junik - Gjeravice" me nr. të prokurimit: 636-19-5225-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Junik.

Me datën: 07.05.2020, OE "Arfa", ka parashtruar ankesë me nr: 281/19, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, me titull: "Ndertimi i rruges Junik - Gjeravice" me nr. të prokurimit: 636-19-5225-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Junik.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 4,856,000.00€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 17.07.2019, data e hapjes së ofertës: 26.08.2019, data e vendimit per anulim te aktivitetit: 16.04.2020, data e njoftimittë ofertuesve: 16.04.2020.
Ankesat janë të përsëritura.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankues Joos Krasniqi, ne ankesen e tij ka pretendime ankimore lidhur me mos respektimin e dispozitave te neneve: 1, 7, 24.2, 51, 56, 59, 60, 68, 69, 72 dhe 80 te LPP-se, njeherit i njejti i jep argumentet e veta se i ploteson ne teresi kerkesat e dosjes se tenderit dhe njeherit pretendon se AK-ja gjate rivleresimit ka emeruar personat e njejte te cilet kane qene edhe ne komisionet paraprake dhe poashtu pretendon se nuk jane respektuar vendimet paraprake te PSH-se.

OE ankues Arfa poashtu ka pretendime lidhur me arsyen e eliminimit dhe i njejti pretendon se padrejtesishte eshte eliminuar nga AK-ja.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Kerkesat e dosjes se tenderit:
Gjendja Ekonomike dhe Financiare:
Kerkesa:
3. Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë në vlerë prej së paku 300,000.00 €.
Deshmia:
3. Dokumenti të jetë i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar qe deshmon se OE ka mjetet financiare te gatshme sipas kerkeses.

Kapaciteti teknik dhe profesionale:
Kerkesa:
9. Operatori Ekonimik duhet të ofroj deshmi nga Banka Listat e pagave që deshmojnë se janë kryer obligimet ndaj stafit dhe punëtorëve.
Deshmia:
9. Nga Banka (Lista e pagave) të Operatorit ekonomik që deshmon se ka kryer obligimet ndaj punetoreve (minimum 50 punëtorë) për 6 muajt e fundit e nenshkruar dhe vulosur nga banka.

Kerkesa:
10. 1(një) Buldozer D7, 3(tre) Kamion per transport te betonit (Autobetonierkë - mixer), (2) Auto pompë betoni, 1(një) Auto Cisternë , (2) Makina për gërryerjen e asfaltit.

Kerkesa:
13. Operatori Ekonomik ofertues (ne rast te konsorciumit-Lideri i konsorciumit) duhet te dëshmoj se ka kryer vlerësimin e riskut për te gjitha pozitat për konform ligjit 04 L-161.
Deshmia:
13. Të dëshmohet me vërtetim nga një kompani e licencuar nga MPMS, se ka kryer vlerësimin e riskut për të gjitha pozitat konform ligjit 04L-161. (Vërtetimi duhet te jetë i noterizuar).

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
OE ankues Joos Krasniqi eshte i papergjegjshem me arsyetimin se:

Nuk e plotësoni kërkesën numër 3. te kapacitetit ekonomik dhe financiar, të vendosur në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit nga Autoriteti Kontraktues - Komuna Junik, ku **kërkohet që operatori ekonomik duhet të ketë kapital të mjaftueshëm në bankë për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë në vlerë prej së paku 300,000.00 €,** ndërsa ju si operatorë ekonomik ofertues keni ofruar një dokument që dëshmon se institucioni financiar (Banka) i'u mbështet me shumën e lartëcekur vetëm në rast se i plotësoni të gjitha kriteret e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit nga Autoritetit Kontraktues, pra nese e fitoni projektin në fjalë banka do t'iu mbështet

financiarisht, kjo dëshmi e ofruar nga ana juaj nuk është dëshmi që Autoriteti Kontraktues ka kërkuar lidhur me gjendjen ekonomike dhe financiare sepse kriter i AK- së ka qenë që operatori ekonomik i përgjegjshëm të ketë para të gatshme (300,000.00€) në bankë dhe jo leterpërkrahje nga institucioni financiar (banka) për mbitërheqje të kësaj shume finnaciare. **Kështu, bazuar në nenin 39. pika 39.8, paragrafi 14, te Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik** ***"nese deshmia mbi gjendjen ekonomike dhe financiare nuk përmbushë kërkesat minimale të vendosura nga Autoriteti Kontraktues që nënkupton që deshmia mbi gjendjen ekonomike dhe financiare e ofruar nga ana juaj nuk është deshmia (dokumenti financiar) siç kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, oferta juaj-tenderi duhet të refuzohet pa kërkuar informacion të mëtutjeshëm".***

Te kërkesa me numër 9, pika III.2.4. kapaciteti teknik dhe profesional, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që ky kriter të plotësohet me dëshminë si në vijim: **Nga banka (lista e pagave) të operatorit ekonomik që dëshmon se ka kryer obligimet ndaj punëtoreve (minimum 50 punëtorë) për 6 muajt e fundit e nënshkruar dhe e vulosur nga banka.**
Ndërsa, ju si operatore ekonomik ofertues keni ofruar një listë të pagave ku punëtorët e kontraktuar në këtë listë marrin pagë nga ju si punëdhënësi i tyre përmes llogarive në institucione të ndryshme financiare, e dëshminë e ofruar pra këtë listë e keni vulosur dhe nënshkruar vetëm nga një institucion financiar (nga një bankë) kurse punëtoreve tuaj paga i'u del në institucione të ndryshme bankare e qe është dashur sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues të nënshkruhet nga secila banke ku punëtoret marrin pagën përmes llogarisë bankare nga punëdhënësi i tyre, që nënkupton se kjo kërkese nuk është plotësuar siç është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues - Komuna Junik.
Kërkesa me numër 10, të kapacitetit teknik dhe profesional nuk është plotësuar sipas kriterit të vendosur në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit nga AK, sepse në dëshmitë e ofruara lidhur me Buldozer D7 nga ana juaj si operatore ekonomik keni deklaruar qe i ofroni 3 Buldozer të tillë, ndërsa në vend të Buldozerit D7 keni ofruar buldozer D150, D5 dhe cater pillar CAT 953 (të cilin e keni paraqitur kinse D10), këto makineri kanë kapacitet më të vogël se makineria Buldozer D7 që do të thotë nuk e plotësoni këtë kërkese të Autoritetit Kontraktues. Po ashtu, dokumentet që keni ofruar për autopompat e betonit, autobetonjerkat - mikser dhe auto - cisternë janë të paidentifikueshme që bie në kundërshtim me kriterin e Autoritetit Kontraktues.
Po ashtu në makineritë e ofruara nga ana juaj mungon një makinë për gërryerjen e asfaltit kurse një makine tjetër për gërryerjen e asfaltit që është prezantuar nga ana juaj i mungon dudi doganor.

Si dhe nuk e plotëson kërkesën me numër 13. të kapacitetit teknik dhe profesional të vendosur në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit nga Autoriteti Kontraktues - Komuna Junik, **ku thuhet që operatori ekonomik ofertues (në rast koncersiumi - Lideri i koncersiumit) duhet te deshmojë se ka kryer vlerësimin e riskut për të gjitha pozitat për konform ligjit 04 L-161.**
Ndërsa ju keni ofruar dëshmi për vetëm 5 punëtorë, që nënkupton se është në kundërshtim me kriterin e vendosur nga Autoriteti Kontraktues dhe është kriter i paplotësuar sipas kriterit në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

OE ankues Arfa eshte eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se me vendimin e OSHP-se, i njejti eshte ne listen e zeze.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Pergjigje ne pretendimet ankimore te OE ankues Joos Krasniqi:

Sa i perket arsyes se pare te eliminimit, qe ka te beje me kerkesen nr. 3 te gjendjes ekonomike dhe financiare, per te cilen OE ankues pretendon se e ploteson me arsyetimin se ne ofert e kemi dorezzuar deshmin me numer: MDI 1923400003 te leshuar nga Raiffeisen Bank, me te cilen eshte garantuar mbeshtja financiare ne vlere prej: 300,000.00 euro.

Eksperti shqyrtues, vlereson se nuk qendron ky pretendim i OE ankues, per faktin se ne dosje te tenderit nuk eshte kerkuar leter mbeshtetje nga banka per vleren e kerkuar, por para te gatshme. Prandaj, AK-ja me te drejte e vleresuar se i njejti nuk e ploteson kerkesen me nr. 3 tek gjendja ekonomike dhe finanaciare, sepse AK-ja ka kerkuar, citat:

Kerkesa:

Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë në vlerë prej së paku 300,000.00 €.

Deshmia:

Dokumenti të jetë i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar qe deshmon se OE ka mjetet financiare te gatshme sipas kerkeses.

Sa i perket arsyes se dyte te eliminimit, qe ka te beje me kerkesen nr. 9 te kapacitetit teknik dhe profesional, per te cilin pretendon i ka dorezuar deshmit sipas kerkeses se dosjes se tenderit.

Eksperti shqyrtues, fillimishte sqaron se kjo arsye e njejte e eliminimit eshte trajtuar edhe me pare, prandaj e konsideron si ceshtje te gjykuar, per faktin se eshte sqaruar se deshmit e leshuara nga banka per mbi 50 punetoret punetoret e kerkuar nga AK-ja, nuk eshte e vulosur, por fakti qe i njejti operator ekonomik e ka dorezuar listen e ATK-se dhe listat e Administrates Tatimore te Shqiperise, eksperti shqyrtues, vlereson se OE ankues ka ofruar deshmi te mjaftueshme se i njejti i ka mbi 50 punetore ne gjashte mujorin e fundit. Prandaj, ky pretendim qendron.

Lidhur me arsyen e eliminimit, qe ka te beje me pajisjet, ku AK-ja e permend faktin se OE ankues nuk ka dorezuar deshmit per nje Buldozher D7 i kerkuar ne dosje te tenderit. Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ka ofruar buldozher D5, D150 dhe D10 Cater Pillar Cat 953. Duke u bazuar ne kerkesen e dosjes se tenderit eksperti shqyrtues vlereson se OE ankues nuk e ka plotesuar kerkesen e AK-se, per pajisjen e lartpermendur.

Sa i perket pajisjeve tjera: Autopomp e betonit, Autobetonjerk - mikser dhe autocistern, per te cilat AK-ja ne arsyetimin e dhene eshte deklaruar se deshmit jane te paidentifikueshme, eksperti shqyrtues, sqaron se ne oferten e OE ankues jane disa deshmi te cilat jane te palexueshme, mirepo eksperti shqyrtues vlereson se nuk mund te vleresohet si mospermbushje e nje kerkese fakti qe nje dokument eshte i palexueshem, pa nje verifikim te atij dokumenti sipas nenit 72 te LPP-se.

Poashtu sa i perket pajisjes per gerryerjen e asfaltit, per te cilen AK-ja eshte deklaruar se i mungon dudi doganor, eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ne listen e pajisjeve e ka deklaruar gerryesen e asfaltit dhe per te njejten ka ofruar faturen e blejres.

Sa i perket arsyetimit te AK-se, lidhur me kerkesen nr. 13 te kapacitetit teknik dhe profesional, eksperti shqyrtues, e konsideron si qeshtje te gjykuar per faktin se per te njejtin pretendim OE ankues ka ofruar prova ne seancen e pare.

Lidhur me pretendim e OE ankues se AK-ja, ne kundershtim me dispozitat e LPP-se ka caktuar anetare te komisionit persona te njejte te cilet kan qene edhe ne vleresimet tjera si anetar te komisionit.
Eksperti shqyrtues, vlereson se ky pretendim qendron pjeserishte per faktin se dispozitat e LPP-se nuk e rregullojne nje situat te tille por qe praktik ka qene qe anetaret te jen te ndryshem, mirepo duhet pas parasysh faktin qe kjo lend eshte ne rivleresim qe disa here.

Ne fund eksperti shqyrtues, vlereson se pavaresishte shkeljeve procedurale te konstatuara me larte, ne rastin e kerkesen per mbi 50 punetoret dhe dokumenteve te paidentifikueshme te cilat AK-ja eshte dashur ti verifikoje, eksperti shqyrtues, vlereson se nuk kan ndikuar ne rrezulltatin perfundimtare, per faktin se OE Joos Krasniqi nuk e ka plotesuar kerkesen nr. 3 te kapaciteti mbi gjendjen ekonomike dhe financiare dhe kerkesen nr. 10 ne lidhje me buldozherin D7.

Pergjigje ne pretendimet ankimore te OE ankues Arfa:
Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues Arfa, ne ankesen e tij, jep argumentet e tij se i njejti padrejtesishte eshte eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit dhe njeherit pretendimin e tij e bazon edhe ne nje interpretim te KRPP-se.
Eksperti shqyrtues, sqaron se pretendimet e OE ankues nuk kan te bejne me kerkesa te dosjes se tenderit dhe se per kete ceshtje ka vendosur paneli shqyrtues, prandaj e konsideroj si ceshtje te gjykuar nga ana e PSH-se.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve ankues te refuzohen si te pabazauara, ndersa vendimi i AK-se per anulim te aktivitetit te prokurimit te mbete ne fuqi.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KOMUNA JUNIK.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE - ANKUES.

Raiffeisen BANK

To: Municipality of Junik
Junik, Kosovo

From: Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.
Edmond Hoxha str. 27
Prishtina, Kosovo

Date: 23 August 2019

RBKO Ref: MD1923400003

Re: Letter of Comfort

We note that JOOS KRASNIQI-BAZE SHPK, JUNIK KOSOVO is a client of good standing with Raiffeisen Bank Kosovo.

The bank may support JOOS KRASNIQI-BAZE SHPK, JUNIK KOSOVO with EUR300,000.00 (Three hundred thousand Euro) credit for implementation of the project: Construction of road Junik-Gjeravicë, procurement no. 636-19-5225-5-1-1, internal no. 636-19-022-511 subject to fulfillment of internal criteria of the bank for such facility.

We confirm that we are a bank registered in Kosovo and which is not on the "blacklist" of the Financial Action Task Force (FATF).

Please also note that we, Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C., UCK Street No.51, Prishtina, Kosovo have no financial obligations towards the beneficiary based on the issued letter of comfort.

Sincerely yours,

Raiffeisen Bank Kosovo

Fatmir Lani
SE Relationship Manager

Trim Gashi
SE Relationship Manager

Lista e Paisjeve dhe Makinerive per Projektin me titull: **Ndërtimi i rrugës Junik-Gjeravicë** me nr te Prokurimit: **636-19-5225-5-1-1** e nr të brendshëm: **636-19-022-511**

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (cope)	Sasia që ofron ofertuesi	Të dhënat për pajisjet (viti I prodhimit ,gjendja e pajisjes , kamiona rexh. I targave,mekanizimi ,dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim ,foto etj)
1	1 (një) Buldozer min D7	1	3	Buldozer Marka Fiat Hitachi, Tipi D150, Nr shasis: 192104-76042579A5, Viti i Prodhimit 1993. Deshmia Kontrrat e Blerjes me dt: 18.05.2015. Pronsi **"Joos&Krasniqi-Bazë"Sh.p.k.** Ne gjendje te rregullt. Buldozer D5 Marka Carterpillar, Tipi CATD5MX, Viti I prodhimit 2002, Nr serik: CAT00D5MC66N02988. Pronësi **"PE-VLA-KU"Sh.p.k.** Ne gjendje te rregullt Buldozer D10 Marka Carterpillar, Tipi CAT953, Viti I prodhimit 1982, Nr serik: 76Y01547. Pronësi **"PE-VLA-KU"Sh.p.k.** Ne gjendje te rregullt
2	7 (shtatë) ose ekuivalnet Ekskavator te ndryshem	7	8	Eskavator Marka: Wacker Neuson, Tipi 3503 RD, Nr shasis: AG05142, Viti I Prodhimit 2011, DUD R 19642. Pronsi **"Joos&Krasniqi-Bazë"Sh.p.k.** Ne gjendje te rregullt. Eskavator Marka: CAT, Tipi 307 B, Nr shasis: CAT0307BCAFB0171, Viti I Prodhimit 2001, Fatura Nr 120/2015. Pronsi **"Joos&Krasniqi-Bazë"Sh.p.k.** Ne gjendje te rregullt. Eskavator Marka: FIAT HITACHI, Tipi EX 135, Nr shasis: ZBF137WAT00000094, Viti I Prodhimit 1999, DUD R 3932. Pronsi **"Joos&Krasniqi-Bazë"Sh.p.k.** Ne gjendje te rregullt.

SH.P.K. JOOS KRASNIQI-BAZE 810962309 Junik

SH.P.K. Nr. Unik Identifikues: "PE-VLA-KU" 810794463 Dega në Kosovë